

Hapet Thirrja për Bursa për Studentët në Universitetin Lodz, Poloni në kuadër të Programit Erasmus + për semestrin e dytë të vitit akademik 2017/2018.

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Lodz, Poloni, për semestrin e dytë të vitit akademik 2017/2018.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor
- Master

Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor/Master (4.5 muaj);

Fushat e studimit:

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti Lodz, klikoni në adresën:

<http://iso.uni.lodz.pl/erasmus/programmes>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (750 EUR në muaj për studentët);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

➤ **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:**

- CV (në gjuhën angleze);
- Forma e aplikimit;
- Letër Motivimi në gjuhën angleze;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash;
- Letër Motivimi në gjuhën angleze;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B2);
- Kopje e pashaportës
- Diplomë Bachelor (në gjuhën Angleze, vetëm për studentët Master)
- Listë notash Bachelor (në gjuhën Angleze, vetëm për studentët Master)
- Dokumente të tjera që konfirmojnë kualifikimet dhe arritjet e kandidatëve
- *Dokumenti Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillojnë në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të marrin në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Lodz lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel Fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Për regjistrimin online klikoni linkun:

<https://enrolment.uni.lodz.pl/>

Dokumentacioni dërgohet dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës dhe më pas procesi i aplikimit kryhet online.

Afati për aplikim: **18 Dhjetor 2017**

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!